

KONCEPTI I BESËS NË NOVELËN “PRILLI I THYER” TË ISMAIL KADARESË: NJË ANALIZË GJUHËSORE

Jonida CUNGU¹, Aurela BASHA²

^{1*}Departamenti i Gjuhësisë, Fakulteti i Shkencave Humane, Universiteti i Elbasanit “A. Xhuvani”

^{2*}Departamenti i Gjuhësisë, Fakulteti i Shkencave Humane, Universiteti i Elbasanit “A. Xhuvani”

jonida.cungu@uniel.edu.al, aurela.basha@uniel.edu.al

Abstrakt

Besa, si një nocion thelbësor në kulturën shqiptare, përfaqëson një detyrim moral që ndikon në vendimet dhe veprimet e personazheve. Nga pikëpamja leksikore, Kadare ka shtënë në tekst fjalë/nocione të veçanta dhe shprehje të lidhura me *besën* për të krijuar një atmosferë të ngarkuar emocionalisht, duke përfutur një kuptim të thellë të dinamikës së marrëdhënieve ndërpersonale. Në këtë punim kemi qëllim të trajtojmë konceptin kanunor të *besës* në novelën “Prilli i thyer” të Ismail Kadaresë, duke u fokusuar në analizën gjuhësore, leksikore dhe semantike të saj. *Besa* kanunore e Kadaresë formëson doktrinën kadariane, cila mbështetet në elementet: kanun, fizikë dhe moral dhe trajtohet në analogji me doktrinën epikuriane. Në vepër evidentohet një gamë e pasur dhe e nuancuar leksemash dhe sintagmash rreth konceptit të *besës*, e cila rreh në përcaktimin e identitetit dhe moralit të individëve dhe shoqërisë. Ndërsa analiza semantike mëton të zbulojë se *besa* është e lidhur jo vetëm me nderin dhe besnikërinë, por gjithashtu me ndjenjat e frikës dhe tensionit që karakterizojnë situatat e vështira. Kjo qasje gjithashtu synon të ndriçojë simbolikën e këtij konceptit dhe fushës përkatëse konceptore që lidh individët me traditat e tyre, duke reflektuar sfidat e jetës moderne dhe ndikimin e kanunit në realitetin bashkëkohor shqiptar. Në përfundim, analiza gjuhësore thekson rëndësinë e konceptit të *besës* si një pikë kyçe për të kuptuar marrëdhëniet sociale dhe etike në veprat e Kadaresë.

Fjalët kyçe: koncepti i *besës*, kanuni, identiteti, simbolika, analizë gjuhësore.

1. Hyrje

Shkolla filozofike epikuriane (shek.IV-III p.e.r) përpunoi një teori të natyrës morale, me qëllim që njerëzit të mbajnë një qëndrim praktik të volitshëm përballë dhimbjes dhe vdekjes (Hersh, Zh. 1993). Doktrina epikuriane ndahet në tri pjesë: kanuni, që përmban tërësinë e normave dhe rregullave të domosdoshme për kërkimin e së vërtetës; fizika, teoria mbi të cilën janë vënë në zbatim normat e rregullat; morali, që përcakton qëllimet që duhen ndjekur në jetë dhe mjetet për t'i arritur. Qëllimi i filozofisë epikuriane është të ndihmojë njerëzit për të gjetur lumturinë, duke shmangur si pengesë frikën nga vdekja. Sipas kësaj filozofie duhet që me ndihmesën e kanuneve, të përpunohet një fizikë, e cila bën të mundur mposhtjen e frikës ndaj vdekjes.

Në trojet shqiptare, kanuni mendohet se është ngjizur në periudhën e viteve 1458-1481, kohë kur Lekë Dukagjini, prijës i principatës së Dukagjinësve dhe bashkëohës i Skënderbeut, udhëhiqte kuvendet dhe pleqësitë e malësorëve. Që prej asaj kohe, kanuni shënoi, jo vetëm një kod zakonor, i cili shërbeu si rregullator normash e sjelljesh në bashkësinë shqiptare, por edhe si dhe temë kryesore në vepra të ndryshme letrare. I emërtuar një kod zakonor, i cili shërbente si rregullator normash e sjelljesh në bashkësinë shqiptare, e më konkretisht në pjesën veriore të Shqipërisë, kanuni i Lekë Dukagjinit është një fabrikim mjeshtëror i fjalës shqipe në përgjithësi, e sidomos i fjalës së rrallë shqipe (Cungu, J. 2020). Edhe pse më së shumti kanuni është studiuar si një kod zakonor me interesa të mëdha në fushë të së drejtës, ai u shfrytëzua për vlerat e mirëfillta gjuhësore dhe pasuritë e pashfrytëzuara leksikore.

Në themel të kanunit shqiptar mbizotëron ‘besa’, si baza e të gjithë rregullave dhe normave zakonore shqiptare. ‘Besa’ sipas Albert Doja (2021) është një premtim solemn për të

mbështetur diçka të rëndësishme, ose për t'u bashkuar me dikë për një veprim të përbashkët, ose në një marrëveshje kolektive me garancinë e fjalës së dhënë që premtimet e bëra do të respektohen dhe nderohen në mënyrë absolute. Kanuni shqiptar është një nga veprat madhore që ka pasqyruar vlerën dhe peshën e 'besës' në jetën shqiptare.

Një nga veprat letrare që do të jetë dhe objekt studimi në këtë punim, është novela "Prilli i thyer". Koncepti kanunor i 'besës' do të jetë në fokusin e këtij punimi, duke u përqendruar në analizën gjuhësore, leksikore dhe semantike të saj. Tema e kanunit, e trajtuar si një strukturë arkitekturore e traditave zakonore, zërthehet përmes shprehësisë leksikore që përzgjedh Kadare për të përshkruar këtë monument madhështor rregullash të ashpra jetësore. Doktrina kadariane risjell edhe njëherë tjetër doktrinën epikuriane, të cilën do ta analizojmë përmes tri elementeve thelbësorë që i gjejmë në veprën "Prilli i thyer": kanuni, si si ekzistenca për jetën; fizika, si zbulim i ligjeve të natyrës, pra njeriu midis kohës dhe hapësirës, si dhe morali, si element i ndërgjegjes.

2. Metodologjia

Për realizimin e këtij punimi janë shfrytëzuar dhe përdorur metoda hulumtuese dhe analizuese. Në veprën "Prilli i thyer" janë vjelë fjalë të dialektit geg dhe shprehje frazeologjike. Vjelja është realizuar në mënyrë manuale dhe fjalët janë identifikuar dhe krahasuar me përdorimin e tyre në kanunin e "Lekë Dukagjinit" dhe me "Fjalor i gjuhës së sotme shqipe 2006". Korpusi gjuhësor është analizuar nga aspekti gjuhësor, leksikor dhe semantik, për të kuptuar doktrinën kadariane në vepër, analogjinë me doktrinën epikuriane, e cila realizohet përmes shtjellimit gjuhësor të konceptit 'besë'. Analiza gjuhësore, leksikore dhe semantike është mbështetur në fjalësin e përzgjedhur të novelës dhe konkretisht në identifikimin e gegizmave që përdor Kadare. Vjelja e materialit gjuhësor të novelës ka qenë shteruese dhe e plotë, me qëllim që të krahasohej me leksikun e përdorur të "Kanuni i Lekë Dukagjinit".

3. Diskutime dhe rezultate

3.1. Kadare përballë doktrinës epikuriane: Krahasimi i Kadaresë me doktrinën epikuriane përkon me qasjen sesi njerëzit përpiqen të shfrytëzojnë natyrën, për t'u çliruar nga frika e vdekjes dhe për kërkimin e së vërtetës. Nëpërmjet shprehësisë brilante leksikore dhe përzgjedhjes së mjeteve gjuhësore, Kadare përshkruan dhe detajon në vepër elementet e doktrinës epikuriane. Duke gjykuar për pasurinë gjuhësore të Kanunit, shprehjet (fazeologji, fjalë të urta etj.) zënë një vend jo vetëm të rëndësishëm, por të padiskutueshëm, duke dhënë një ngjeshje a homogjenitet të përkryer të mendimit, model i ndërtimit gjuhësor, që me pak fjalë (kurrë më tepër se një fjali) përmbyll diskutimin, duke dhënë vendimin e prerë për një çështje (Luka, D. 2017). "Prifti s'bie në gjak", një nga thëniet më të njohura të kanunit, na njeh me rregullin qindravjeçar, i cili përsëritet disa herë në gojën e Gjorgut. Mjafton një konstrukt sintaksor dhe kemi të pasqyruar një nga vendimet më të fuqishme kanunore. Pesha e thënies "...se vetëm po të ishte prift nuk do të kishte të bënte me kanunin", si një mënyrë për të arritur qëllimin e tij, shpëtimin nga gjakmarrja, shpjegon moralin si element filozofik epikurian. Dhe vetë qenia e Gjorgut, që endet në kohë dhe në hapësirë shpjegon elementin fizik të filozofisë. Përqasja me filozofinë epikuriane është e shkrirë në të gjithë rrjedhën e njëtrajtshme të ligjërimi të Kadaresë, e cila zërthehet përmes lëvizjes së mendimit, nga kanuni drejt moralit, nëpërmjet kohës dhe hapësirës. Autori realizon lëvizjen në hapësirë përmes përdorimit të toponimeve: fshati Brezftohtë, Kullën e Oroshit, Varret e Krushqve, Rruga e Madhe e Bjeshkëve të Nëmura, Rruga e Hijës, Drinit të Zi, Drinit të Bardhë, Rruga e Keqe, Rruga e Madhe e Flamurëve, Rruga e Kryqit, Rrafshi, Ura e Gurtë, Gështenjat e Mëdha, Arat e Rekës, Mulliri i Shurdhit, Rruga e Currajt, Kroi i Ftohtë, Konakët e Nikajve e të Shades, Hani i Vjetër, Hani i Vejushës, Tetë

lëfytet e Kroit të Zanave, Konakët e Rrëzës, Livadhi i Krillave etj. Nga ana gjuhësore, përdorimi i toponimeve të shumta i jep mundësi personazhit të endet në mënyrë të pandalshme në hapësirë, ndërsa koha mbetet në vend, në të tashmen dhe të shkuarën që jeton personazhi.

Te shqiptarët, institucionit të ‘besës’ i njihen disa funksione të veçanta, sidomos në kontrollin e forcave të errëta të hakmarrjes (Doja, A. 2021). Momente të tilla janë ilustruar nga ana gjuhësore me shumë mjeshtëri te vepra “Prilli i thyer”, duke krijuar panoramën e zbërthimit të kanunit. Në kontekstin e thënies “*Miku, besa dhe gjaku janë si nyjet e tragjedisë antike dhe, të hysh në mekanizmin e tyre, do të thotë të pranosh mundësinë e tragjedisë*” shtjellet koncepti i kanunit përmes tri fjalëve, që semantikisht mbartin fuqinë me konotacion më të lartë në vepër: miku, besa dhe gjaku. Pra, kanuni është besa.

Simbioza e kanunit (ligjeve të jetës), fizikës (ligjeve të natyrës) dhe moralit (ligjeve të ndërgjigjegjes) shprehet nëpërmjet përdorimit të dendur të elementeve shprehës apo shprehjeve frazeologjike, si: “*Shtëpia e shqiptarit është e zotit dhe e mikut*”, (kanuni); “*Miku është kategoria më e lartë etike në jetën e shqiptarit*”, (moral); “*Ai është plot enigmë dhe vjen drejt e nga mbretëria e fatit, apo fatalitetit*” (fizika e hapësirës); “*Krushqve s’u ndalet udha, edhe sikur të kesh të vdekur në shtëpi*”, (kanuni); “*Në shtëpi s’hyhet pa thirrë e pa u përgjegjë kush*”, (kanuni dhe morali); “*Fytyrën e vruguar në daç laje, në daç zezojë dhe më*” (kanuni); “*Shtëpia e malësorit, përpara se të ishte e njerëzve të shtëpisë, ishte e Zotit dhe e mikut*” (moral, kanuni); “*Në mos punofsh me të drejtë, kjo peshë t’u rëndoftë në atë jetë*” (moral); “*Ky gur e kjo balte m’u rëndofshin në këtë e në atë jetë*” (moral); “*Gjaku i babës dhe i djalit mund të falet, i mikut kurrë*” (kanuni); “*Lisi i gjakut, thirret gjaku nga babai dhe lisi i tëmblit, thirret gjaku nga nëna*” (kanuni, fizika, morali) etj.

3.2. *Mbi gegizmat e Kadaresë*: Madhështia e të drejtës zakonore shqiptare në novelën “Prilli i thyer” konfigurohet përmes gjuhës së zgjedhur, e cila paraqet shprehësi leksikore të veçantë. Emërtimi që i është vënë “Prillit të thyer” si “romani i veriut” (Sinani, Sh. 2023), sjell në vëmendje leksikun e pasur të gegërishtes, përmes përzgjedhjes së kujdesshme të fjalëve të rralla nga vepra “Kanuni i Lekë Dukagjinit”. Kadareja vlerësohet si një përrues i pasurisë gjuhësore të kanunit, duke sjellë të gjalluara fjalë të rralla (ashtu siç i quan A.Vehbiu në shkrimin e tij “Fjalë të rralluara”, të cilat nuk gjenden më të përdorura as në fjalorët shpjegues të gjuhës shqipe. Kadareja shkruan në gjuhën standarde, por megjithëse me prejardhje nga trevat jugore të Shqipërisë, ai është mjeshtër në ndërkalljen në veprën e tij të fjalëve dhe shprehjeve nga gegërishtja, një pjesë e tyre të moçme dhe të harruara prej kohësh (Çabej, M. 2011). Kadare e përzgjedh fjalën në vepër si gur të çmuar, duke shpalosur një pasuri të larmishme gjuhësore përmes kundërvënies së dialektit geg dhe tosk njëkohësisht, psh: *Zhurma e guriçkave të rrugës nën thundrat e opingave të Gjorgut...; Shtëpi quhet një kullë, një kasolle, a gjithçka tjetër, mjaft që të ketë çaranin e vatrës e të qesë tym...; Gjakësi ishte një djalë i ri...; rrëzoi mbi shpinë kapuçin e qullur të xhokes ...; Veçimi ose lëçitja, sic quhej në kanun...; etj).*

Përdorimet gege i gjejmë përgjatë gjithë veprës, duke natyralizuar fjalë në funksion “të tëhollimeve të panumërta që ndërmer për përpunimin e ligjërimit të veprave të veta (Çaushti, T., Shkurta, Gj. 2004). Disa shembuj janë: *prozhmi, pllengash, e nëmur, ndajnatë, traga, flakadanë, dërgatë, gjëmëtarët, xhoket, kësolltarëve, gjakësi, fshiknin, të vithisur, tirqve, frëngji, maliheri, shurdhane, pleqnarët, duajt, krillave, grosh, të çakërritur, buiste, fërgëllonte, gufmohej, farfuritur, bokërimat, çaranin, karvanarët, krushkapar, duvak, zhargas e rrëshqanthi, han, lahutari, trokëllitur, përcellësi, bujtësi, tëharrje, hakërrim, djerrina, vorbë, dhoga, xhoke, lëkurçe, hanxhi, grosh, qillota, shkoqitës kanuni, pleqsi, pleqnarë, zaten, grindësve, zallinë, katundisht, gjakhupës, prozhmja, përçor etj.*

Roli i tij në këtë vepër duket se i shkon për shtat krahasimit me studiuesin Qemal Haxhihasani, i cili mblodhi përgjatë gjithë vitetve të jetës, fjalën e bukur shqipe në terren. Brenda novelës “Prilli i thyer” qëmtojmë fjalë, grupe fjalësh, shprehje frazeologjike, neologjizma, të cilat janë

përdorur në kontekstin e gegërishtes së Rrafshit të Dukagjinit, për të shpërfaqur pasurinë gjuhësore, leksikore dhe semantike. Një pjesë e mirë e këtyre fjalëve nuk përdoren në ligjërimin e përditshëm, por ato vijjnë natyrshëm dhe bëhen pjesë organike e gjuhës së përdorur.

3.3. *Koncepti kanunor i 'besës'.* Analizë gjuhësore, leksikore dhe semantike: 'Besa' vjen si koncept i rimarrë të "Prilli i thyer", pasi Kadare e ka trajtuar atë më parë edhe në vepra të tjera. Në kontekstin e brendshëm, kanuni shenjon 'besën'. E mbartur nga tri personazhe që gjatë gjithë kohës udhëtojnë, janë në lëvizje, besa e kanunit (element i ligjeve të jetës) orvatet nëpër Rrafsh përmes lëvizjes (element i ligjeve të natyrës). Gjuhësisht, Kadare e shpërfaq këtë përmes përdorimit të foljeve që semantikisht tregojnë lëvizje: udhëtonte, ecte, kaloi, afrohej, avitej, shpejtonte, vrapoi, zgjatej, kapërceu, lëvizte, u vërtit, ngjitej, u drejtua etj. Në vepër hasim edhe paragrafë të caktuar, ku konteksti i thënies shpreh vetëm lëvizje: "Ai ishte më i fuqishëm se ç'dukej. Ishte i shtrirë kudo, zvarrisej nëpër tokë, në kufij arash, futej në themele shtëpish, nëpër varre, kisha, rrugë, tregje, dasma, ngjitej gjer në kullotat alpine, madje edhe më lart, gjer në qiellin vetë, prej nga zbriste në forme shiu, për të mbushur vijat e ujit, për të cilat bëheshin një e treta e vrasjeve".

Lëvizja është një nga konceptet bazë të ligjeve të natyrës, e cila është zgjedhur nga Kadare për të vënë në qarkullim rregullat kanunore, besën e kanunit, që të realizojë plotësimin e moralit, ndërgjegjen për hakmarrjen. Kjo lëvizje fizike e personazhit shoqërohet me lëvizjen e fjalës 'besë' në formulimin e disa gjedheve leksikore si: *besa e vogël/besa njëzetekatërorëshe; besa e madhe/besa tridhjetëditëshe; besëprerëse, besëshkelës, pabesi, besnikëri, e besëtuar* etj.

Lënda që ai zgjedh dhe përdor në veprën e tij, rigjallëron fjalë të moçme të trevave të veriut, si: *kacnec (lajmëtar, tellall), muranë, gurapesh, gjakhupës, deledash, avlëmend, hupës, verminë, dorëras, çeltinë, thirrëvajë, rub, kësolltarë*, etj. Këto fjalë janë prurje të drejtpërdrejta nga ligjërimet e gegërishtes, të cilat shpërfaqin vlerën e mëtimeve gjuhësore të autorit. Një nga studiuesit që ka shqyrtuar fjalësin e veprave të Kadaresë është edhe studiuesi Tefik Çausi, i cili ka këqyru se në të gjithë prozën e tij ka rreth 2000 fjalë dhe forma a kuptime fjalësh, shumica e të cilave nuk gjenden në "Fjalorin e gjuhës së sotme shqipe" (Shkurtaç, Gj. 2009). Shembuj të tillë janë: *dorësasi* (ai që vret dike me dorën e vet), *dërgatë* (përfaqësi), *kësolltarë* (pjesëmarrës në një mort), *krillave* (lloj zogu), *qillota* (pantallona), *curis, bubuzharë, verminë, gërgah, zymtor, mokrat, cfobësohen, thirrëvaj, kanuntar* (e drejta kanunore), *bërlykej* etj. Kadare zgjedh të përdorë fjalë, të cilat kanë qenë jashtë syrit të përdoruesve e ndoshta në rrezik zbehjeje të plotë apo humbjeje. Përdorimi i këtij korpusi gjuhësor, si dëshmi e thesarit leksikor, duket se dhurohet shqiptarëve nga vetë Kadare, për të duke vendosur, nëse kjo pasuri gjuhësore do të shihet si pasqyrim ligjërimor i së shkuarës, apo do të ketë fatin e përfshirjes në fjalorët shpjegues.

Koncepti i 'besës' përligjet në tekst semantikisht, ku kuptimi i fjalës jepet në mënyrë denotative dhe konotative. "Të gjithë e kuptonin se ishte fjala për besën e vogël, njëzetekatërorëshen. Kurse besën e madhe, tridhjetëditëshen, akoma s'e përmendte kush, sepse atë nuk mund ta kërkonte familja, por katundi dhe, veç kësaj, ajo mund të kërkohej vetëm pas varrimit të të vrarit. Ishte i mbrojtur nga besa njëzetekatërorëshe më mire se nga çdo frëngji kulle apo kështjelle. Tytat e pushkëve të tyre çoheshin drejt mbi xhoket e zeza, por tani për tani ato s'kishin të drejtë të shtinin mbi të. Nesër, pasnesër... ndoshta. Kurse, po të kërkonte katundi besën tridhjetëditëshe për të, atëherë do të kishte edhe katër javë jetë të qetë. Mbasdite, pas drekës së mortit, në katund nisi prapë ecejaka e pazakonshme. Pas disa orësh mbaronte besa e vogël njëzetekatërorëshe për Gjorg Berishën dhe qysh tani pleqnarët e katundit po bëheshin gati të paraqiteshin, sipas të gjitha rregullave, te kulla e Kryeqyqëve, për të kërkuar për Gjorgun, në emër të fshatit, besën e madhe, tridhjetëditëshen." Përsëritja e fjalës 'besë' në sintagma të ndryshme përforcon ngarkesën kuptimore, duke shpërfaqur përdorime dhe kuptime në kontekste të ndryshme. Psh.: *kohën e besës së madhe; e pabesueshme; shtëpie besëprerëse;*

prerja e mikut në besë; pabesi; katund besëshkelës; besë flamuri; mbaj besën; besnikëri; bujtina e besëtuar; bujtina në besë; rrugë në besë; udhë në besë, i besëtuari; koha e besës-koha kanunore; koha përtej besës-koha eterne, etj. Në çdo kuptim të përdorur të fjalës ‘besë’ shenjon kanunin, moralin dhe ligjet e natyrës. Doktrina kadariane, kanun-fizikë-moral shtrin ndjesinë e saj në fjalësin e zgjedhur dhe ngarkesën kuptimore. ‘Besa’ identifikohet si shenjë në veprën “Prilli i thyer”. Ajo ka formën dhe përmbajtjen e saj, e cila gjendet në çdo deje të veprës letrare, ashtu si elementi ‘besë’ krijon fushën e saj semantike sipas përdorimeve në sintagma të ndryshme. Kanuni është ‘besa’ në veprën “Prilli i thyer”, koncept i cili ka peshë filozofike, gjuhësore dhe semantike.

Përfundime

Kadare mbetet ndër shkrimtarët e rrallë që ka dhënë një ndihmesë të vyer për gjuhën e vet amtare. Në lëmin e leksikut shquhet për një mjeshtëri të veçantë, e cila shfaqet në simbiozën e gegërishtes dhe toskërishtes të përdorur në të njëjtën kohë edhe në të njëjtën fjali. Fjalësi i zgjedhur drejtpërdrejt nga ligjërimet e gegërishtes dhe kuptime të ndryshme fjalësh janë të rralla, sa disa prej tyre nuk gjenden as në fjalorët shpjegues të gjuhës shqipe. Kjo tregon aftësinë e autorit për të ligjëruar me elemente të rralla, por që mbartin peshën e rëndësishme të fjalëve të rralluara.

Doktrina kadariane përkon me doktrinën epikuriane, ku lidhja kanun-fizikë-moral shpalolet përmes pasurisë gjuhësore, leksikore dhe semantike në të gjithë rrjedhën e njëtrajtshme të ligjëritimit. Përdorimi i foljeve që semantikisht lidhen me kuptimin e lëvizjes apo hapësirës i përgjigjet ligjeve të natyrës apo fizikës së doktrinës epikuriane. Koncepti i ‘besës’ shenjon kanunin, moralin dhe ligjet e natyrës. Ajo shpërfaqet semantikisht përmes ngarkesës semantike që merr fjala, në sintagma të ndryshme përdorimore në fjali, të cilat Kadare i paraqet me një mjeshtëri të rrallë artistike.

Referencat

- [1]. Cungu, J. (2020). “Lexical value in the “Canon of Lekë Dukagjini”, Uluslararası Balkanlar, Anadolu, Kafkasya ve Türkistan coğrafyası sanat, kültür, tarih ve folklor kongresi
- [2]. Doja, A. (2021). Beja, besa dhe feja. Peizazhe të fjalës.
- [3]. <https://peizazhe.com/2021/09/28/beja-besa-dhe-feja/>
- [4]. Çabej, M. (2011). Gegizmat në veprën e Kadaresë. Studime albanologjike, universiteti I Tiranës.
- [5]. Çausi, T., Shkurtaj, Gj. (2004). Kadareja dhe fjala shqipe, Tiranë.
- [6]. Hersh, Zh. (1993). Habia filozofike. Një histori e filozofisë. Dituaria, Tiranë.
- [7]. Kadare, I. (1978). Prilli i thyer.
- [8]. Luka, D. (2017). Pasuria gjuhësore e Kanunit të Lekë Dukagjinit. Studime gjuhësore, vëllimi 19,
- [9]. https://archive.org/details/luka_20230715/page/220/mode/2up
- [10]. Sinani, Shaban. (2023) Kanuni total të “Prilli i thyer”. Studime filologjike, fq.132.
- [11]. https://albanica.al/studime_filologjike/article/vieë/4217/4294
- [12]. Shkurtaj, Gj. (2009). Shqyrtime rreth prurjeve leksikore të Ismail Kadaresë”, në “Pesha e fjalës shqipe”, UFO press, Tiranë.
- [13]. Vehbiu, A (2007) “Fjalë të rralluara”, “Peizazhe të fjalës”, <https://peizazhe.com/2007/08/17/fjale-te-rralluara/>